

# SHOQËRIA E LIRË

CIVIL

MEDIA TË LIRA PËR SHOQËRI TË LIRË  
NJUSLETER #1, SHTATOR - TETOR VITI 2017



**BOTIM SPECIAL**

## Taverna e Ballkanit dhe liria

XHABIR DERALLA, CIVIL

Në ditën e votimeve më 15 tetor dhe ditëve më pas, më pyesnin disa neutralë dhe ca djathtëstë dashamirë ashtu si me shaka: "Edhe? Të lira janë zgjedhjet?". Them, PO, pa dyshime dhe pa u "ndezur" fare në ironinë e butë (dhe jo aq të butë). Nuk jam burokrat dhe asnjëherë nuk do të jem. Nuk e kam ndërmend të hidhem me fraza të shpëlara, edhe më pak me eksel tabela dhe numra bezdisëse, si të jemi në ndonjë aheng të mërzitshëm me tombole. Këtë do t'ua lë atyre që nuk kanë imagjinatë, si dhe më pak ndjenja për pulsën e shoqërisë.

Hyra në qendrën për shtyp të Civilit me nervozizëm të madh. Nga viti 2008 e këndej, çfarë nuk pashë dhe dëgjova, përjetova shumë presione. Duke i falënderuar histerisë që e përhapnin shërbëtorët e qelbur të agjitprop makinerisë dhe "shtetit të thellë"

të Gruevskit (Ordanoski numëroi një pjesë të mirë nga ato këto ditë), jeta ime dhe e rreth njëqind luftëtarëve për liri ishte e vendosur në akull të hollë. Prandaj, ditën e zgjedhjeve e fillova me nervozizëm dhe me kujdes të veçantë.

Mirëpo, dita kaloi kryesisht e mbushur me raporte për folklorin dhe grotesken në të cilën gjendet një shoqëri sapo e liru. Dita ishte e plotë me situata të tensionuara, disa rrahje, një numër i konsiderueshëm i gabimeve të papranueshme të adminis-


tratës zgjedhore dhe me ushtarë ta partive nga të gjitha anët, të cilët sikur nuk e dinë se çfarë do të thotë heshtje zgjedhore. Dhe ryshfet votues, për të cilin dua të kushtoj kohë të posaçme këto ditë. Dhe shumë marrëzira tjera të natyrshme shpesh, për tavernën e Ballkanit. Dhe, liri.

Po, këto ishin zgjedhjet e para pas një okupimi tepër të gjatë të shtetit dhe dhunës së përditshme dhe shkeljes së dinjitetit njerëzor. Shumica e qytetareve dhe qytetarëve ishin të inkurajuar të dalin dhe

të votojnë me vullnetin e tyre. Dhe me numrin më të madh deri tani të fletëvotimeve të pavlefshme (45.551 për kryetarë komune dhe 51,681 për këshilla komunale, do të thotë pothuajse 100.000!), me të gjitha gabimet amatore në materialin zgjedhor, me Listë të Votuesve të keqe...

Më gjithë këtë ndërmend, mund të them se u ndje fryma e lirisë. Për herë të parë pas një kohe të gjatë. Me të gjitha gabimet që nuk guxojnë të përsëriten. Dhe me të gjithë shembujt jo të mirë të shkeljes së të drejtës votuese. Me kërkesën e zëshme që liria të sigurohet për të gjithë, deri te i fundit!

Për anën më të errët të zgjedhjeve, në rafalët e ardhshme (të freskuara) me nga 25 rende, që lexohen maksimum për një minutë dhe tretën tërë ditën. Dietale! (tani vijon smiley)



# Administrata zgjedhore e shkaktoi numrin më të madh të parregullsive

## RAPORTI I DYTË PAS-ZGJEDHOR I CIVILIT

**C**IVIL – Qendra për Liri ka përgatitur raport për parregullsitë nga monitorimi zgjedhor dhe e dorëzoi në Komisionin Shtetëror Zgjedhor më 17 tetor, në ora 17:10. Kjo është vetëm raport dhe jo ankesë, sepse organizatat e shoqërisë qytetare nuk janë të autorizuar për dorëzim të ankesave, por këtë mund ta bëjnë vetëm bartësit e listave të kandidatëve dhe qytetarët dhe qytetarët. Megjithatë, Civili dorëzon raport deri në KSHZ në afatin ligjor për ankesa, me shpresa se ky institucion do të veprojë sipas kompetencave dhe në bazë të informatave tona, do të merr masa përkatëse në korniza të ligjit. Një gjë e këtillë nuk ndodhi në zgjedhjet e vitit të kaluar.

Civili ka zbatuar seleksionimin dhe verifikimin e rreptë të mbi 240 raporteve të përpunuara për parregullsi zgjedhore, të dërguara deri te Trupi Koordinues për zgjedhje i organizatës në ditën e heshtjes zgjedhore dhe në ditën e zgjedhjeve. Ekipi analitik ka ndarë gjithsej 199 raporte në të cilat dëshmohet për shkelje të heshtjes zgjedhore, presione dhe kërcënime, sjellje joligjore të bordit zgjedhor, probleme me Listën e Votuesve, votim familjar dhe grupor, shkelje të fshehtësisë së votimit, tejkalim të autorizimeve, ryshfet votues dhe dhunë.

Sipas statistikave të Civilit, numri më i madh i parregullsive shënohen në kategorinë “Veprim joligjor i Këshillit Zgjedhor (KZ), respektivisht 28,14%. Në gjashtë raste, vëzhgues të akredituar në ditën e zgjedhjeve janë përfshirë në ndonjë parregullsi zgjedhore, votuesit janë përfshirë në 14,54% nga raportet e dorëzuara për parregullsi zgjedhore, ndërsa janë shënuar edhe 2 raste të dhunës.

Kategoria “Tjera” në Tabelën 1. Përfshin 44 raste të problemeve me materialin zgjedhor, siç janë numri dhe cilësia e fletëvotimeve, mosfunksionimi i UV llambave, mospasja e qasjes deri në vendvotimet, vendosja e keqe e paravanëve për personat me aftësi të kufizuara dhe një varg problemesh tjera që janë në mënyrë të tërthortë të lidhura me performancat e këqija të administratës zgjedhore, duke përfshirë KSHZ dhe Komisionet Komunale Zgjedhore.

Nga ana tjetër, siç ishte e theksuar edhe në konferencat për shtyp të Civilit gjatë ditës së zgjedhjeve, si dhe në konferencën për shtyp menjëherë pas zgjedhjeve, një pjesë e madhe e këshillave zgjedhore ishin të detyruar të tregojnë shumë kreativitet

dhe durim, që të zbatohen zgjedhjet. I pritnin fletëvotimet me gërvshë, qëndronin para kutive që t’u shpjegojnë votuesve ku ti vendosin fletëvotimet, sepse ishin të paqarta dhe me ngjyra të ngjashme, disa stilolapsa nuk funksiononin, nuk punonin UV llambat, duhej t’i rinumërojnë të gjitha fletëvotimet, dhe shumë veprime tjera.

Edhe pse duhet të jetë përgatitje rutine, pas kaq proceseve zgjedhore të zbatuara, KSHZ këtë herë përgatiti material zgjedhor i cili ishte sfidë serioze për të gjithë, e në masë më të madhe për votuesit dhe këshillat zgjedhore.

Megjithatë, një numër i madh i këshillave zgjedhore nuk e kryenin detyrën e tyre sipas procedurave dhe ligjit. Më saktë, në pyetjen “Kush e shkaktoi parregullsinë?” në sistemin e Civilit për regjistrimin e të dhënave nga terreni, administrata zgjedhore është vepruesi më i shpeshtë. Madje në 121 raporte flitet për administratën zgjedhore (nga KSHZ deri te këshillat zgjedhore) si përgjegjëse për parregullsitë, respektivisht 60, 80% nga raportet e dorëzuara në KSHZ.

Përsëri, si dhe në proceset e kaluara zgjedhore, vëzhguesit tonë shënojnë se anëtarë ose udhëheqës të këshillave zgjedhorë ashpër i shkelin procedurat dhe Kodin Zgjedhor. Një pjesë nga ato janë shënuar si -agjirim ose bashkëpunim me shtabet partiake në mobilizim të votuesve. Gjithashtu, ata në disa raste, të shënuara nga vëzhguesit e Civilit, e lëndojnë të drejtën e votimit me shënim joadekuat të spërkatësit ndaj votuesve të cilët pastaj zbulojnë se nuk gjenden në Listën e Votuesve në atë vendvotim, që më pastaj ata të pamundësohen të votojnë në vendvotimin përkatës.

Një pjesë e këshillave zgjedhore bëjnë gabime të trasha edhe për arsye të mosnjohjes së procedurave. Civili dhe para zgjedhjeve alarmoi se KSHZ dhe komisionet komunale zgjedhore nuk mundësojnë trajnim cilësor për anëtarët e këshillave zgjedhore, përkundër përgatitjeve të shtrenjta dhe të gjata të materialit edukativ (video, doracakë...).

Në raportin parazgjedhor të Civilit, mes tjerash qëndron se: “Komisionet Komunale Zgjedhore të cilat duheshin t’i trajnojnë anëtarët e Këshillave Zgjedhore nuk i kushtuan kohë të duhur trajnimit. Vlerësojmë se nuk mjaftojnë 30 minuta, nga të cilat, 10 janë prezantim i shkurtë, e pasta video projektim nga i cili anëtarët e KZ arrijnë deri te dijenitë,

gjegjesisht, instrukcione për veprime përkatëse në ditën e zgjedhjeve. Kjo nuk mjafton dhe përsëri do të gjendemi në situatë në të cilën anëtarët e KZ madje edhe pa qëllim do të duhet t'i shkelin procedurat dhe ligjin sepse nuk kanë informata të mjaftueshme.”

Sa i përket të drejtës së votimit, kjo edhe në këto zgjedhje ishte e lënduar në disa qindra raste, kur një pjesë e qytetareve dhe qytetarëve nuk kishin mundësi ta realizojnë të drejtën e tyre fundamentale njerëzore – të drejtën e votimit. Në raportin parazgjedhor të Civilit, alarmohej: “Kemi mbi 120 raste të votuesve të “zhdukur” nga Lista e Votuesve. Shohim shumë raste indikativë dhe simptomatike se KSHZ, respektivisht administrata nuk arrin t’u përgjigjet kërkesave të qytetareve dhe qytetarëve.” Për më tej, Civili e kritikoi arrogancën e institucioneve me konstatimin:

“Pasi që pamë rast, gjegjesisht, presedan ligjor, kur në kohë të zgjedhjeve, në kundërshtim me parimet e standardeve ndryshohet ligji, ndryshohet edhe struktura e KSHZ, atëherë mundeshin të gjinden resurse dhe kohë të zgjidhet problemi me qytetarët dhe qytetarët të cilët në ditën e zgjedhjeve eventualisht nuk do të mund të gjenden në Listën e Votuesve. Nuk duhet të shkohet tepër larg, mjafton të shihen përvojat Kroate dhe të shihet se ka mundësi për thjeshtësimin e mundësimit të së drejtës votuese qytetareve dhe qytetarëve. Kjo është shkelje e të drejtave të njeriut dhe shkelje e ligjit. Madje edhe një rast i tillë do të jetë lëndim serioz i të drejtave fundamentale të njeriut.”

Këto parashikime u realizuan.

Aktivistët e partive politike kishin të bëjnë sikur nuk ekziston ndalesë për veprim partiak në kohë të hes-

htjes zgjedhore. Ata, thjeshtë, nuk e ndërprejnë fushatën, dhe janë të shënuara edhe raste të presioneve dhe kërcënimeve partiake, agjitim, mobilizim dhe transport i votuesve, si dhe ryshfet. Ndahet rasti kur janë regjistruar aktivistë partiakë të cilët në mes të ditës kanë ngjitur pllakate në një nga rrugët kryesore në komunën Butel.

Në Aerodrom priteshin parregullsi zgjedhore, sipas përvojës paraprake nga monitorimi zgjedhor i Civilit, gjë që edhe u realizua. Në raportin e parë, Civili paraqet 22 raste të parregullsive zgjedhore pikërisht në këtë komunë. Ato raste nënkuptojnë veprim joligjor të administratës zgjedhore, partive dhe aktivistëve të partive, votim familjar dhe grupor...Në Kumanovë janë regjistruar 14 raste të parregullsive zgjedhore edhe atë më tepër për sjellje joligjore të këshillave zgjedhorë, votim familjar dhe grupor dhe probleme me listën e votuesve.

Civili përkujton se këto janë të dhëna nga 199 raporte nga terreni më në fund të miratuara. Raportet tjera përpunohen, por nuk pritët ndryshim serioz në statistikën përfundimtare. Ndërkohë, Civili boton raporte të veçanta të cilat flasin për parregullsitë zgjedhore në detaje.

Sipas metodologjisë së miratuar nga Civili, çdo gjë që vjen si raport nga terreni, përpunohet dhe menjëherë publikohet përmes platformave mediatike CIVIL Media dhe është në dispozitë për opinionin, që do të thotë se raportet e Civilit vazhdimisht mbindërtohen me të dhëna të reja dhe japin pasqyrë detajore dhe gjithëpërfshirëse.

botuar në: [www.drejt.mk](http://www.drejt.mk)

## Fletëvotimet e pavlefshme janë paralajmërim deri te politikanët

**P**othuajse 100.000 fletëvotime të pavlefshme u numëruan pas rrethit të parë në zgjedhjet vendore. Nga ato, 45.551 ishin për kryetarët e komunave dhe 51,681 për këshillat komunale. Kjo është rritje dramatike e numrit të fletëvotimeve të pavlefshme.

Gjatë analizës së parë të kësaj dukurie, përfundohet se për këtë ka së paku dy arsye. Arsyeja e parë është materiali problematik për të cilin Civili gjerësisht informonte gjatë ditës së zgjedhjeve.

Arsyeja e dytë, edhe më e rëndësishme, është “votimi protestues”, gjegjesisht, anulimi i qëllimshëm i fletëvotimit. Votuesit në atë mënyrë e shprehin protestën e tyre, gjegjesisht, vërejtjen e tyre deri te kandidatët për marrjen e pushtetit



në nivel lokal. Nëse ndonjëherë votuesit shpesh votonin “kundër”, dhe jo “për” ndonjë opsion politik, tani shprehin mosbesim ndaj të gjithë pjesëmarrësve në garën zgjedhore.

Në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit të kaluar kishte 38.000 fletëvotime të pavlefshme, numër për të cilin Civili kërkoi edhe ekspertizë të posaçme, por nuk ishte e pranuar. Ky numër tani është vërejtje dramatike e votuesve edhe deri te pushteti lokal.

Nga Civili paralajmërohet se analiza e kësaj dukurie do të vazhdojë dhe se do të del me analiza të reja, edhe më të qëndrueshme pas mbarimit të procesit zgjedhor.

# CIVIL Media – hapësirë për qëndrime të ndryshme dhe stacion i rregullt për informimin e qindra mijëra qytetareve dhe qytetarëve

CIVIL Media është njësi organizate e CIVIL -Qendrës për Liri. Në kornizat e saja, funksionon redaksia me gazetarë dhe gazetarë profesionistë, por edhe fillestarë që kanë vendosur që përgatitjen e tyre ta mbindërtojnë me punë praktike gazetarë-hulumtuese.

Ueb faqja [www.civilmedia.mk](http://www.civilmedia.mk) është një nga përmbajtjet më të dukshme të projektit Media të lira për shoqëri të lirë. Është e specializuar për politikë, shoqëri dhe kulturë. Për çdo ditë, ekipi i projektit prodhon së paku dhjetë përmbajtje autoriale në format tekstual ose video. Para zgjedhjeve lokale, kjo ueb faqe është resurs i veçantë publik për edukimin dhe informimin për rrjedhën e këtij procesi të rëndësishëm zgjedhor.

Slllogani i kësaj ueb faqeje është: LIRSHËM, PAVARUR, HAPUR.

Çdo ditë tentojmë ta arsyetojmë këtë slogan me botimin e informatave objektive dhe në mënyrë të hapur dhe konstruktive e kritikojmë çdo dukuri në shoqëri. Në rubrikën MENDIMI, pothuajse

çdo ditë publikohen qëndrime dhe mendime të intelektualëve të lartë, ekspertëve dhe aktivistëve. Qëndrimet e tyre jo çdo herë janë në pajtim me qëndrimet e Civilit ose të donatorëve të organizatës, mirëpo janë hapësirë e rëndësishme përmes cilës ne angazhohemi për forcimin e kulturës dhe dialogut politik.

Në periudhën e kaluar kjo ueb faqe u bë stacion i rëndësishëm në të cilin qindra mijëra qytetarë dhe qytetarë për çdo ditë informohen për ngjarje të rëndësishme për proceset shoqërore – politike dhe për qëndrimet e ndryshme të kolumnistëve dhe analistëve tonë.

Përmbajtjet e publikuara në këtë ueb faqe janë të lira për marrje, sipas licencës Creative Commons, që do të thotë se mund të publikohen edhe në media tjera, me kusht që të paraqitet autorja/autorit dhe burimi (me link), si dhe disklejmer në të cilin paraqiten të dhënat themelore të burimit dhe projektit.

[www.civil.org.mk](http://www.civil.org.mk)  
[www.civilmedia.mk](http://www.civilmedia.mk)  
[www.civilalb.info](http://www.civilalb.info)  
[www.civil.today](http://www.civil.today)

[www.youtube.com/c/CivilMacedonia](http://www.youtube.com/c/CivilMacedonia)  
[www.youtube.com/user/CivilOrgMK](http://www.youtube.com/user/CivilOrgMK)  
[www.facebook.com/civil.mk](http://www.facebook.com/civil.mk)  
[www.facebook.com/citizen.journalists.mk](http://www.facebook.com/citizen.journalists.mk)  
[www.facebook.com/sezaizbori](http://www.facebook.com/sezaizbori)  
[www.facebook.com/socijalna.pravda.drejtesi.sociale](http://www.facebook.com/socijalna.pravda.drejtesi.sociale)  
[www.facebook.com/FreedomCaravan](http://www.facebook.com/FreedomCaravan)  
[www.facebook.com/speak.up.mk](http://www.facebook.com/speak.up.mk)  
[www.twitter.com/CivilMacedonia](http://www.twitter.com/CivilMacedonia)  
[www.twitter.com/Slobodnilzbori](http://www.twitter.com/Slobodnilzbori)  
[www.twitter.com/BeFreeMK](http://www.twitter.com/BeFreeMK)  
[www.soundcloud.com/civil-org-mk](http://www.soundcloud.com/civil-org-mk)

[www.cip.mk](http://www.cip.mk)  
[www.freedom.mk](http://www.freedom.mk)  
[www.greencivil.mk](http://www.greencivil.mk)  
[www.slobodnilzbori.info](http://www.slobodnilzbori.info)  
[www.zgjedhjetelira.info](http://www.zgjedhjetelira.info)  
[www.freeelections.info](http://www.freeelections.info)

## PARAQITNI:

- Shkelje të të drejtave të njeriut
- Shkelje të drejtës votuese
- Parregullsi zgjedhore
- Mobing dhe presione politike
- Keqpërdorim të resurseve publike

Paraqituni në: 02/5209176  
[www.facebook.com/civil.mk](http://www.facebook.com/civil.mk)  
[civil@civil.org.mk](mailto:civil@civil.org.mk)

## Për CIVILin

CIVIL –Qendra për Liri është shoqatë nacionale qytetare jopërfituese në fushën e tjetër drejtave të njeriut, paqe dhe kontrollit të armëve, e themeluar më 25 nëntor të vitit 1990. Joformalisht, organizata është aktive nga viti 1996.

Vëzhgimi zgjedhor zbatohet nga viti 2008, duke vendosur metodologji të me efektivitet të lartë të vëzhgimit dhe edukimit qytetar për të drejtat votuese.

Në kërkim të vizionit të vet, misioni i Civilit është: promovimi aktiv dhe mbrojtja e të drejtave dhe lirive të njeriut; paqes së qëndrueshme dhe proceset e pajtimit; krijimit të planeve për kontrollin efektiv të armëve; drejtësi sociale dhe liria e shprehjes.

Civili është aktiv në nivel rajonal dhe ndërkombëtar, dhe ka zbatuar mbi 100 projekte, duke i përfshirë edhe fushatat për ngritjen e vetëdijes nacionale, evenimente të mëdha publike, etj. Organizata gëzon dukshmëri të madhe dhe besim nga të gjitha bashkësitë në vend.

Projekti Media të lira për Shoqëri të lirë është i financuar nga Ministria Federale për punë të jashtme të Republikës Federale të Gjermanisë.

Këtë botim e përgatiti ekipi i projektit të CIVIL -Qendrës për Liri. Personi përgjegjës; Xhabir Deralla. Qëndrimet e shprehura në këtë publikim janë të autorëve dhe autorëve të teksteve dhe nuk i pasqyrojnë çdo herë qëndrimet e donatorëve.